



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
OSNOVNI SUD MITROVICI - BASIC COURT OF MITROVICA

P.nr.830/2016

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i përgjithshëm, me Gjyqtarin e vetëm gjykues Bekim Veliqi, procesmbajtëse Valdete Sadiku, ne çështjen penale ndaj te pandehurit A.F, nga ..., për veprën penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.9 e lidhur me par.6 e 1 te KPRK-es, sipas Aktakuzës se Prokurorisë Themelore ne Mitrovicë Departamenti i përgjithshëm PP.nr.252/2015, dt.07.12.2016, e përfaqësuar nga Prokurori i Shtetit Jellena Marjanoviq, përfaqësuesit te palës se dëmtuar-vellau V.B, ne prezence te pandehurit A.F, mbrojtësit te tij sipas autorizimit av.A.D, pas mbajtjes se seancës se shqyrtimit fillestare dhe publike me dt.31.05.2019, ne bazë te nenit 359, 360, 361, 362, 366, te KPP-se, është marre dhe shpallur publikisht aktgjykimi, ndërsa aktgjykimi është përpiluar me dt.26.06.2019;

A K T G J Y K I M

I akuzuari;

A.F, nga i ati M., e ëma M. e, e gjinisë T., i lindur me dt. ..., ne , ku dhe jeton rr. "...", me nr.personal ..., Shqiptarë, Shtetas i Republikës se Kosovës, vozitës, i martuar, prind i një fëmijë, ka te kryer shkollën e mesme ekonomike, i gjendjes se dobët ekonomike, nen masën e paraburgimit qe nga dt.16.03.2015 deri me dt.27.03.2015 dhe nen masën e arrestit shtëpiak qe nga dt.27.03.2015 deri me dt.16.04.2015, ndaj tij nuk zhvillohet procedure për ndonjë vepër tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE; Me dt.16.03.2015, rreth orës 15:35 min, në rrugën magjistralen ...-..., saktësisht ne fsh. ... Komuna e ..., në afërsi të Shkollës Fillore, nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik si dhe jetën e njerëzve, duke shkaktuar aksident me pasoja fatale, ashtu qe duke drejtuar automjetin e tij të markës "Renault Clio", ngjyre hiri, me targa të regjistrimit ..., e në kundërshtim me dispozitat 54,88 dhe 150 te LSKRR, sepse shpejtësinë e lëvizjes nuk ja ka përshtatur kushteve dhe gjendjes në rrugë si dhe pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion, nuk e ka përdorur burinë, si dhe nuk ka pasur kujdes ndaj këmbësoreve që hyjnë në rrugë, ashtu që me pjesën e përparme të anës së djathtë të automjetit e godet këmbësoren-të dëmtuarën E.B tani e ndjera, e cila në ato momente ishte duke kaluar rrugën nga ana e majtë në anën e djathtë, në drejtim të lëvizjes së automjetit si dhe pasojë e kësaj goditje, kembësorja-tani e ndjera përplasët në kapakun e motorit dhe në Parafangon e anës së djathtë të automjetit dhe rrëzohet për toke, ku merr lëndime vdekjeprurëse si pasoj e gjakderdhjes në tru (contra coup).

Me ketë ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 e lidhur me par.6 e 1 te KPRK-es.

Andaj gjykata ne baze te nenit 4, 7, 17, 23, 41, 45, 73 te KPRK-se, dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366, te KPP-se i;

S H Q I P T O N

DENIM ME BURGIM ne kohëzgjatje prej dy (2) vite, te cilin dënim do te vuaj pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, ne te cilin dënim do te llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit - arrestit shtëpiak që nga data 16.03.2015 deri me dt.16.04.2015.

I akuzuari obligohet te paguaj shpenzimet procedurale dhe atë për ekspertizën e ekspertit te komunikacionit shumen prej 40.88€, ndërsa ne emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej

50€, te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nen kërcënimin e përbarimit te dhunshëm.

Pala e dëmtuar për realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civilo-juridik.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore ne Mitrovice Departamenti i Përgjithshme ka parashtruar Aktakuzën PP.nr.252/2015, dt.07.12.2016, ndaj te pandehurit A.F nga ..., për veprën penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.9 e lidhur me par.6 e 1 te KPRK-es.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar dt.12.09.2018, eshte parashtruar kërkesë nga mbrojtësi i te pandehurit për mundësin ligjore qe pranë Prokurorisë te arrihet marrëveshje për pranimin e fajësisë, pas dëgjimit te Prokurorit te Shtetit dhe përfaqësuesit te palës se dëmtuar, propozimi është aprovuar nga Gjykata, ne dhënien e mundësie për arritje te marrëveshje ndërmjet palëve ne mbështetje te nenit 233 te KPP-se.

Me date 01.04.2019, Gjykata ka pranuar njoftimin nga Prokurori i Shtetit, se palët nuk kane pranuar marrëveshje për ndërmjetësim, procedura ka vazhduar me caktimin e seancës fillestar, gjate seancës se shqyrtimit fillestar, ka prezantuar Prokurori i Shtetit Jelena Marjanoviq, i pandehuri A.F dhe mbrojtësi i tij av.A.D, i angazhuar sipas autorizimit, përfaqësuesi i të ndjerës, vëllai V.B, sipas deklarimit te përfaqësuesit ligjor – prindit F.B ne seancën e shqyrtimit fillestar te dt.12.09.2018.

Gjate kësaj seance te shqyrtimit fillestar i pandehuri është udhëzuar dhe njoftuar me te drejtat e tij komfor nenit 246 par.1 te KPP-ës, pas deklarimeve te te pandehurit është vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e Prokurorit te Shtetit, i pandehuri është deklaruar se e kupton aktakuzën dhe pas bindjes se gjyqtarit se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, i është ofruar mundësia qe te pranoj fajësinë apo te deklarohet i pafajshëm, i pandehuri është deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet ne barre sipas aktakuzës.

Gjykata e ka njoftuar te pandehurin për pasojat e pranimit te fajësisë se vepra penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 e lidhur me par.6 e 1 te KPRK-es, është e dënueshme me burgim prej një (1) deri ne tete (8) vite, duke e njoftuar se sipas nenit 383 par.2 te Kodit te Procedurës Penale ne rast te pranimit te fajësisë nga i pandehuri i njëjti nuk e ka te drejtën e ushtrimit te ankesës ndaj aktgjykimit nga baza për shkak te vërtetimit te gabueshëm ose jo te plote te gjendjes faktike, duke e njoftuar se provat gjate kësaj seance te shqyrtimit fillestar nuk administrohen, por ato vlerësohen me rastin e caktimit te llojit dhe matjes se dënimit, po ashtu pranimin e fajësisë gjykata do ta vlerësoj si rrethane lehtësuese ne rastin e matjes se dënimit.

I pandehuri ka deklaruar se i kupton pasojat e pranimit te fajësisë dhe rrethanat lehtësuese qe i merre gjykata me rastin e matjes se dënimit dhe i pandehuri qëndron pranë pranimit te fajësisë.

Ne mbështetje te nenit 248 par.2 te KPP-es, është kërkuar mendimi i Prokurorit te Shtetit, mbrojtësit dhe te dëmtuarit-perfaqesueti lidhur me çështjen e deklarimit te te pandehurit për pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit lidhur me deklarimin e te pandehurit për pranimin e fajësisë, ka deklaruar se pranimi i fajësisë është ne përputhje me kriteret qe parashihen ne neni 248 te KPP-se, gjykata te aprovoj pranimin e fajësisë, pranimi është i vullnetshëm pa presion, ne konsultim me mbrojtësin, gjykatës i propozoj qe pranimin e fajësisë te merr si rrethana lehtësuese të vlerësimi i dënimit, po ashtu gjykata ti ketë edhe rrethana lehtësues dhe rënduese nëse i gjënë dhe gjykata të merr aktgjykim dënues në raport me të pandehurin.

Mbrojtësi av.A.D ne dhënien e mendimit sa i përket deklarimit për pranimin e fajësisë për veprën penale me te cilën akuzohet i mbrojturi i tij ka deklaruar sipas konsultimeve dhe këshillimeve me

të mbrojturin tim kemi bërë pranimin e fajësisë, ka theksuar se ky pranim qëndron edhe i mëhershëm pasi që ne kemi dhënë një deklaratë me dt.11.09.2018, për të hyrë në marrëveshje me prokurorin për pranimin e fajësisë mirëpo një marrëveshje e tillë nuk është pranuar për faktin se përfaqësuesi i familjes e të dëmtuarës nuk ka pranuar që të hyjë në marrëveshje, dhe se gjykata të aprovojë pranimin e fajësisë.

Përfaqësuesi i te ndjerës E.B, vellau V.B, ka deklaruar se ne fillimisht kemi bërë marrëveshje me të pandehurin, gjykatës i propozoj që të merr një vendim adekuat dhe të jetë mësim për të tjerët që të ketë efektin më të gjerë të pjesëmarrësit në komunikacion, pranimin i fajësisë të mos e marrë si rrethanë lehtësuese.

Pas kësaj gjyqtari është i bindur se i pandehuri e kupton natyrën e pranimin dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe se pranimi është bere ne mënyrë te vullnetshme dhe ne konsultim me mbrojtësin dhe se pranimi është mbështetur ne faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike, andaj Gjyqtari ne procesverbal ne kuptim te nenit 248 par.4 e lidhur me par.1 nenpar.1.1, 1.2, 1.3, 1.4, te KPP-es, ka marrur aktvendim duke pranuar pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit.

I pandehuri A.F, ka deklaruar se edhe njëherë shprehi keqardhje për rastin që ka ndodhur që gjykata te merr parasysh se jam familjar, jam mbajtës i vetëm i familjes, jam prind i një fëmije , deklaroj dhe po ashtu se kam me qene me i kujdesshëm ne komunikacion, asnjëherë nuk kam pasur probleme ne komunikacion, kjo me ka ndodhur siç kam deklaruar edhe me larte se jam ne gjendje te rende shpirtërore.

Mbrojtësi i te pandehurit A.F, av.A.D ka deklaruar se rasti i ndodhur ka lënë pasoja emocionale tek i pandehuri se i vjen keq për rastin e ndodhur, se me familjen e të dëmtuarit jan pajtuar dhe sa i përket provave që gjenden në shkresat e çështjes as i pandehuri dhe as mbrojtësi i tij nuk e kundërshtojnë mënyrën e zhvillimit të ngjarjes kritike, se rasti ka ndodhur në lëshimet e të dy anshmet dhe se pranimi i fajësisë përveç që konsiderohet si rrethanë lehtësuese nga ana e gjykatës nuk detyrohet ne kufizimet e nenit 76 të KPRK-së duke konsideruar se gjykata se edhe nën minimumin e dënimit ligjor.

Përfaqësuesi palës se dëmtuar ka deklaruar se qëndroj pranë deklarimeve te theksuara me larte.

Pasi që Gjykata ka pranuar pranim te fajësisë nga ana e te akuzuarit dhe me që nga palët nuk ka pasur propozime për plotësimin e procedurës gjyqtari i çështjes e ka shpallur përfundimin e këtij shqyrtimi, Gjykata ka vazhduar ne mbështetje te nenit 248 par.4 te KPP-es, me shqiptimin e dënimit - respektivisht me shpalljen publike te aktgjykimit, e cila shpallja e aktgjykimit është bere po te njëjtën dite, shpallja ka qene e hapur dhe publike, ne prezence te pandehurit, mbrojtësit te tij, përfaqësuesit te dëmtuar, ndërsa ne mungese te Prokurorit te Shtetit.

Ne lidhshmëri te pranimin te fajësisë nga i pandehuri ne vlerësimin dhe analizimin e provave materiale që janë pjese përbërëse e kësaj çështje penale dhe ne mbështetje te nenit 361 te KPP-es, gjykata vërtetoj se ekzistojnë prova materiale se ne veprimet e te pandehurit kemi te bëjmë me elementet e veprës penale me te cilën akuzohet, kjo konstatohet nga deklarata e te pandehurit dt.16.03.2015, deklarata e dëshmitarit dt.16.03.2015, raporti i aksidentit nr. ..., dt.16.03.2015, skica e vendit te ngjarjes, raporti i QKUK Qendra Emergjente Mitrovicë për te ndjerën E.B, Vërtetimi mbi vdekje dt.16.03.2015 për te ndjerën E.B, Autopsia e dt.16.03.2015, fotodokumentacioni i vendit te ngjarjes, nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit te komunikacionit ku ka konstatuar se lëshimet janë te të pandehurit janë te natyrës primare, andaj te gjitha këto vërtetojnë rrethanat për gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe me këto veprime përmbushen – krijohen elementet e veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 e lidhur me par.6 e 1 te KPRK, te gjitha rrethanat si me larte tregojnë gjendjen faktike te përshkruar si ne dispozitiv te aktgjykimit.

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes se lartësisë së dënimit për të pandehurin gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-ës, ku përcakton se "Kur gjykata cakton dënimin për veprën penale, gjykata duhet të ketë parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të parapare për atë veprë penale",.. që dënimi për këtë veprë penale është dënim me burgim prej një(1) viti deri në tetë (8) vite burgim, gjykata si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, shprehjen e keqardhjes, tani i martuar, prind i një fëmijë, moshën e tij e re, si rrethana renduese gjykata vlerësoj se rasti ka ndodhur në afërsi të Shkollës, siç konstatohet edhe në dispozitiv të aktgjykimit, pjesëmarrësit në komunikacion kanë obligim për kujdes të shtuar, sidomos në afërsi të Shkollave, rrethane tjetër renduese e ndjera e moshës së re- nxënëse mosha e re 16 vjeçare,(viti i lindjes 15.04.1998), shqetësime dhe dhimbje tek familja e të ndjerës E.B, të shprehur edhe gjatë seancës fillestare, siç konstatohet në procesverbal- deklarami i përfaqësuesit të ndjerës që gjykata të ketë parasysh rrethanat dhe pasojën, të pandehurit të caktohet dënim, që do të jete me ndikim edhe të personat e tjerë, gjykata në vlerësim të rrethanave lehtësuese dhe renduese lidhur me rastin, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i këtij dënimi i paraparë sipas nenit 41 të KPRK-ës, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të beje rehabilitimin e tij, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit dhe nga të gjitha këto ka konsideruar se dënim i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallen e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e muar konform neneve 450 dhe 451 të KPP-ës, ndërsa udhëzimi i palëve të dëmtuara për realizmin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil u mbështet në nenin 463 të KPP-es,

Nga theksimet e theksuara si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.830/2016, dt.26.06.2019

Procesmbajtësja
Valdete Sadiku

Gjyqtari
Bekim Veliqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.